



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Republika e Kosovës
http/www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 485/004
Dt 26.03.2019

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 19.03.2019, mori:

VENDIM

- I. Aprovohet rekomandimi i Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me ekzistimin e konfliktit të interesit për kandidatët e përzgjedhur nga komisionet recensuese dhe këshillat e njësive akademike për pozitat: Një Asistent për grup lëndësh në Gjeologji: Gjeologji e përgjithshme, në Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Një asistent për lëndët e Makinerisë prodhuese në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.
- II. Anulohen pjesërisht konkurset për zgjedhjen e personelit të rregullt akademik dhe për bashkëpunëtorë të jashtëm në fakultetet e Universitetit të Mitrovicës, të publikuara në shtypin ditor dhe në ueb-faqen zyrtare të UMIB-it më 13.09.2018.
- III. Anulimi i konkursit të shpallur më 13.09.2018 do të bëhet për këto pozita:
Fakulteti i Gjeoshkencave
 1. Një Asistent për grup lëndësh në Gjeologji: Gjeologji e përgjithshme**Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike**
 1. "Një asistent për lëndët e Makinerisë prodhuese".
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitat nga pika II bëhet bazuar në përgjigjen nr. prot. 03-02/4417/18 të datës 17.12.2018 të Agjencisë kundër Korrupsionit për konfirmimin e konfliktit të interesit të kandidatëve që kanë aplikuar për këto pozita: Albana Koliqi për pozitën "Një Asistent për grup lëndësh në Gjeologji: Gjeologji e përgjithshme"; dhe Shpëtim Salihu për pozitën "Një asistent për lëndët e Makinerisë prodhuese". Bazuar në përgjigjen e AKK-së, si dhe duke pasur parasysh se nuk ka pasur kandidatë të tjerë që i plotësojnë kriteret për këto pozita, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;



Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it